



КОМИСИЯ ЗА ЗАЩИТА ОТ
ДИСКРИМИНАЦИЯ
COMMISSION FOR
PROTECTION AGAINST
DISCRIMINATION



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

dt. 02.03.2022
Prot. 394

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Sot, më 02.03.2022 në qytetin e Tiranës Shqipëri është firmosur memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet:

KOMISIONIT PËR MBROJTJE KUNDËR DISKRIMINIMIT I REPUBLIKËS SË BULLGARISË, përfaqësuar nga Assoc. Prof. Ana DZHUMALIEVA PhD në cilësinë e Kryetares së Komisionit,

dhe

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga PhD. Robert GAJDA në cilësinë e titullarit të institucionit,

në vijim të referuara si "Palët".

Duke njohur potencialin e dy institucioneve për të përhapur ide, iniciativa dhe praktika progresive dhe humane;

Duke marrë parasysh misionin e deklaruar të Palëve për të vënë në shërbim të shoqërisë potencialin e tyre,

Duke kuptuar se bashkëpunimi i organizuar dhe prezantimi më i gjerë publik i roleve, aktiviteteve dhe arritjeve të tyre do të jetë me përfitim të dyanshëm.

Palët dakordësuan si më poshtë:

Neni. 1. Palët shprehin dëshirën e tyre për bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta, të cilat konsistojnë në:



КОМИСИЯ ЗА ЗАЩИТА ОТ
ДИСКРИМИНАЦИЯ
COMMISSION FOR
PROTECTION AGAINST
DISCRIMINATION



Komisioni për Mbrojtjen
nga Diskriminimi
Commission for Protection
from Discrimination

1. Vendosjen e kontakteve për shkëmbimin e përvojës së ekspertëve, hartimin e formularëve të duhur për promovimin e partneritetit dhe për prezantimin e rezultateve të tij.
2. Palët konsiderojnë mundësinë për pjesëmarrjen e përbashkët në projekte kërkimore, sondazhe, konferenca, seminare dhe iniciativa të tjera, duke përfshirë projekte që mund të zhvillohen në kuadër të programeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe anti-diskriminimit dhe promovimit të barazisë dhe mundësive të barabarta .

Neni. 2. Ky Memorandum është me kohëzgjatje të pakufizuar.

Neni. 3. Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Neni. 4. Personat e kontaktit do të jenë:

- Ana Dzhumalieva, Kryetare e Komisionit për Mbrojtje Kundër Diskriminimit të Republikës së Bullgarisë.
- Robert Gajda, titullar i institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Republikës së Shqipërisë.

Ky memorandum është hartuar në tre kopje identike në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, ku të tre tekstet janë njëlloj autentike – një për secilën pjesë.

**KOMISIONI PËR MBROJTJE
KUNDËR DISKRIMINIMIT
I REPUBLIKËS SË BULLGARISË**

**KOMISIONER PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Znj. ANA DZHUMALIEVA



Z. ROBERT GAJDA



dt. 02-03-2022